forumZFD

Numri: 10 ~ 11/2018.

Balkan PERSPECTIVES

Revistë për ballafaqimin me të kaluarën

Ndërtimi i urave me imagjinatë dhe emocion: A MUNDET ARTI TË SJELLË SHËRIM?

AUTORË: KORAB KRASNIQI

PËRMBAJTJA

03 EDITORIALI

04 VOX POPLI

05 LAJME DHE RISI

06 DITËN E SHIRITIT TË BARDH

A ËSHTË E MUNDUR TË FLITET PËR TË KALUARËN, POR NË TË NJËJTËN KOHË TË HESHTET PËR TË TASHMEN DHE TË ARDHMEN?
08

FUQIA E ARTIT PËR BALLAFAQIMIN ME TË KALUARËN
17

20
FUSHATA PËR PAJTIMIN E GJAQEVE 1990- 1991 HISTORIA ORALE DHE KUJTESA

12 EMOCIONALJA MBI TË GJITHA

14 IN SITU: INTERVISTË ME BOJANA STOJMENOVSKAN, DREJTORESHË E FESTIVALIT

24 IMAGJINATA SI E VËRTETË

26 DIAMANTI I SHKUPIT: ÇARSHIA E VJETËR

EDITORIALI

Numri: 10

Të dashur Lexues,

Me shumë kënaqësi ju sjell numrin 10 të revistës sonë **Balkan.Perspectives:** *Ndërtimi i urave me imagjinatë dhe emocion: a mundet arti të sjellë shërim?*

Kur e kaluara ndërtohet nga rrëfime dhe interpretime kundërthënëse, ku asnjëri nuk e pranon tjetrin, ku institucionet nuk munden ose nuk i njohin veprimet dhe pasojat e së kaluarës dhe as narrativat që rezultojnë nga apo janë në themel të tyre, si e arrijnë njerëzit shërimin? Ku nis pajtimi?

Përvoja, trauma, plagët – këto janë personale. Emocioni dhe kujtesa janë subjektive. Ato nuk mund të lihen anash kur ballafaqohemi me të kaluarën, sepse luajnë rol thelbësor në të.

I anshëm apo jo, arti nuk ka pse të ndjekë asnjë rregull – ai mund të hapë tema që përndryshe nuk guxojmë t'i trajtojmë në sferën publike. Njësoj si me kujtesën, që po ashtu mund të jetë subjektive dhe të lejojë qasjen në një kujtesë personale ose kolektive.

Në këtë numër, Borka Paviqeviq sugjeron se arti mund të ndërtojë ura, edhe pse ajo paralajmëron se arti nuk mund të marrë përgjegjësinë e plotë për këtë detyrë dhe as që duhet ta presim këtë prej artit.

Milena Popoviq shkruan se ne mund të përdorim imagjinatën për të gjetur të vërtetën kur faktet humbasin meritën që kanë.

Elma Selman sheh si të vetmen mundësi për të adresuar të kaluarën duke patur të tashmen dhe të ardhmen në mendje përmes shembullit të artit performues dhe të dinamikës që ai krijon me secilin shikues, i cili mund të ndërveprojë me performancën vetëm përmes përvojës dhe interpretimit të vet.

Bojana Stojmenovska flet për festivalin *InSitu Art* në Shkup dhe se si arti ka potencialin të sfidojë stereotipet.

Erëmirë Krasniqi, e cila punon me Historinë Orale në Kosovë, përshkruan ndikimin e rrëfimit të historive personale, duke iu referuar ekspozitës që u mbajt rishtazi *Fushata për pajtimin e gjakmarrjeve* 1990-1991.

Më tutje, numri ynë i 10-të eksploron ndikimin e artistëve kosovarë teksa kërkojnë të përdorin artin për t'i dhënë zë të mbijetuarave dhe për të reflektuar mbi një pjesë të historisë që kryesisht shpërfillet; "Dita e Shiritit të Bardhë" përkujton fëmijët e vrarë në Prijedor ndërmjet viteve 1992 dhe 1995 përmes një tregimi të ilustruar, ndërsa Çarshia e Vjetër në Shkup përdoret si metaforë për diversitetin e vërtetë në jetën e kryeqytetit të Maqedonisë.

Arti dhe kujtesa ofrojnë platformë për individë dhe tema që ndryshe mund të kishin mbetur të padëgjuara – ata mundësojnë që e kaluara dhe ajo që perceptohet si "normale" të dekonstruktohet, duke nxitur reagime autentike njerëzore. Arti është i cenueshëm dhe këtu qëndron fuqia e tij. Me anë të emocioneve tona, të nënndërgjegjes tonë, a mund të gërrmojmë thellë në të kaluarën tonë dhe të ndërmarrim hapa drejt pajtimit?

Shpresojmë se do ta shijoni leximin
e këtij numri të Balkan.Perspectives.

Ju urojmë gëzuar festat e fundvitit!

Vanessa Robinson-Conlon
Kryeredaktore

SI MUNDET ARTI TË NXISË PROCESIN E PAJTIMIT?

BOSNJË DHE HERCEGOVINË

Duke patur parasysh faktin se gjatë të gjithë jetës time kam qenë në kontakt me forma të ndryshme të artit si: filmi, teatri, piktura dhe muzika, unë absolutisht mendoj se arti është një mjet jashtëzakonisht i rëndësishëm diplomatik për të tejkaluar dallimet dhe për të arritur katarsisin. Shumë njerëz nuk ndjehen rehat kur flasin për traumat. Arti mund ta bëjë këtë për ta dhe t'iu ndihmojë gjatë atij procesi. Një nga shembujt më të shkëlqyer të këtij procesi është pjesa *Hypermnesia* nga Selma Spahiq, pjesë e cila bën fjalë për luftën, por në mënyrë të ndryshme, që askush të mos ndjehet i sulmuar dhe që të gjithë të përpiqen të kuptojnë këndvështrimin e personit në anën tjetër.
A.T. (40)

Në mënyrë që arti të ndryshojë diçka, ai duhet të jetë i mirë dhe jo të jetë thjesht një parullë. Arti e ndryshon njeriun dhe nuk ka dyshim për faktin se pasojat e artit serioz dhe të përfshirë mund t'i shërbejnë qëllimit për ta bërë një shoqëri të përballet me traumat e veta më të mëdha.
A.B. (37)

Në ditët e sotme, vetëm personat naivë e nënvlerësojnë kulturën. Ajo konsiderohet si një nga instrumentët më të rëndësishëm për pajtim dhe bashkëekzistencë paqësore. Artistët ngrenë zërin edhe në ato raste kur shoqëritë në tërësi nuk janë në gjendje ta bëjnë. Artistët i përdorin veprat e tyre të artit për të nxitur diskutime publike, për të shkaktuar lëkundje, për të hapur horizonte të reja dhe hapësira për dialog. Kur politikanët nuk janë në gjendje të gjejnë mënyra për të komunikuar, kultura dhe arti e bëjnë këtë. Shpeshherë, artistët janë ata që "ndriçojnë rrugën" në kohëra të errëta, ndoshta pikërisht për shkak të mosgatishmërisë së tyre për të bërë kompromise.
H.S. (35)

KOSOVË

Ndryshe nga politika ose ekonomia, mendoj se arti është një nga ato fusha që ka mundësi shumë të mëdha dhe lirinë për të nxitur dhe ushqyer pajtimin. Si mënyrë për të shprehur emocionet tona më të fuqishme, përvojat dhe imagjinatën, arti mund të shërbejë si mjet që njerëzit i bën bashkë, jo t'i përçajë. Mendoj se kjo mund të arrihet më së miri duke përdorur artin që të na lidhë ne, si qenie njerëzore, qofshim shqiptarë, serbë, romë ose goranë. Më pas, në vend se të përpiqemi të "shpërfillim" etninë tonë, ne mund të përdorim forma të ndryshme të artit për të kuptuar dhe pranuar se si t'i përkasësh një etnie të caktuar të formëson përvojat dhe narrativën. Mendoj se është shumë e rëndësishme që të jemi të vetëdijshëm për paragjykimet dhe t'i dekonstruktojmë ato dhe arti mund të shërbejë si një platformë e shkëlqyer për këtë.
G.R. (24)

Në 30 vitet e fundit, ekspozitat e artit dhe ngjarjet e tjera kulturore që kanë ndodhur mes Serbisë dhe Kosovës, mund t'i numërojmë me gishtat e një dore! Njëherë, një i moshuar serb, pyetjes time se pse rruga magjistrale që lidh Kosovën me Serbinë është e lënë pas dore dhe nuk është investuar në të për më shumë se 30 vite, iu përgjigj: "…po të kishim ndërtuar rrugë të cilat na bashkojnë, nuk do të kishim 'ndërtuar' luftëra mes nesh, që kanë shkatërruar gjithçka të mirë që kemi patur…!" Marr guximin të shtoj se po të kishim ndërtuar "ura" që do të na lidhnin, nuk do të rrënohej gjithçka mes nesh. Kur në një hapësirë (kulturore, politike, sociale) mungon kultura, atëherë vendin e saj e zë jokultura. Dhe e kundërta, ku ka kulturë, jokultura nuk ka vend.
Mehmet Behluli (artist dhe profesor i artit)

Fuqia e artit qëndron në lirinë e artistit për t'u shprehur. Arti nuk ka kufizime politike dhe nuk duhet të jetë korrekt politikisht: arti është i lirë të flasë.
L.M. (27)

SERBI

Është e vështirë të përcaktohet marrëdhënia e saktë apo shkalla se deri ku arti mund t'i kontribuojë pajtimit. Është një pyetje legjitime se përse pajtimi të jetë detyrë e artit. Sidoqoftë, bazuar në vlerat universale njerëzore, arti pothuajse gjithnjë punon "në mënyrë intuitive" në favor të pajtimit. Gjithashtu, është praktikë e zakonshme artistike për t'u angazhuar për shoqëri më të mirë dhe më të drejtë nga kushtet aktuale brenda të cilave krijojnë artistët. Pa dyshim që letërsia, filmat dhe teatri kanë fuqinë të transferojnë faktet, të rrisin njohuritë për disa ngjarje dhe dukuri dhe në të njëjtën kohë, të veprojnë mbi emocionet e publikut duke e bërë atë më empatik dhe më të ndjeshëm. Rrallëherë ka diçka si arti që të na mundësojë të shohim botën nga këndvështrimi i të tjerëve. Të kuptosh këndvështrimin e tjetrit, të ndjesh dhimbjen e tjetrit, është një nga kushtet e pajtimit. Apo së paku, ndjesia e turpit se çfarë u është bërë të tjerëve në emrin tonë. Këtu, mendoj se arti ka fuqi të rrallë.
Staša I. (39)

Termi *pajtim* është keqpërdorur aq shpesh, është vendosur aq shpesh në kontekst të gabuar saqë absolutisht nuk pasqyron dhe është shkëputur me forcë nga problemet e përditshme të njerëzve që jetojnë bashkë në këtë zonë për më shumë se njëzet vjet dhe pothuajse e ka humbur rëndësinë. Në të njëjtën kohë, koncepti i bashkëekzistencës është shumë i rëndësishëm në këtë zonë ku janë bërë disa nga krimet më të këqija të luftës dhe tmerret më të mëdha në tokë evropiane pas Luftës së Dytë Botërore. Mbetet ende pyetja: me kë duhet të arrihet paqja dhe në cilat kushte? Arti në këtë rast përdoret si kuptim i arritjeve të detyrave të projekteve të ndryshme dhe për të arsyetuar fonde që janë investuar në institucione të ndryshme për të cilat të gjithë mund të pajtohemi se kanë qenë të konsiderueshme pas përfundimit të luftës. Prandaj termit pajtim i ka rënë vlera. Arti në këtë kontekst nuk mund t'iu kontribuojë këtyre proceseve, sepse elitat politike kanë fituar mirë gjatë përplasjeve dhe për këtë, gjendja sot është pak a shumë e njëjtë. Në fakt, arti duhet të punojë për të zhdukur konsensusin dhe për të krijuar konflikte. Mbi të gjitha, i referohem antagonizmave shoqërore dhe zhdukjes së

marrëveshjeve ndërmjet elitave politike që duket se funksionojnë në mënyrë të përsosur.
Vladimir M. (37)

Vetëm arti i orientuar nga kritika dhe i angazhuar në aspektin shoqëror mund të nxisë pajtimin. Kjo ndodh për shkak të arsyetimit se vetëm arti dhe shprehja artistike si kjo mund të vënë në pikëpyetje dhe të këpusin narrativat mbizotëruese nacionaliste, idetë e imponuara mitike dhe të kohës së luftës. Për nga natyra e vet, ky lloj i artit është pjesëmarrës. Arti pjesëmarrës është gjithëpërfshirës, ai lidh njerëzit dhe komunitetet dhe priret t'i tejkalojë stereotipet dhe paragjykimet dhe në këtë mënyrë, i kontribuon rrëzimit të mureve ndërmjet anëve të ndryshme të konflikteve dhe shoqërive pas konfliktit.
Srgjan H. (31)

MAQEDONI

Aspektet e ndryshme të aktiviteteve njerëzore për të krijuar artefakte vizuale, audio dhe ekspresive apo thënë thjesht, vepra arti ku mund të shprehim shkathtësitë tona imagjinuese, konceptuale apo teknike, përkufizohen si art. Qëllimi kryesor i artit është të vlerësohet në përputhje me bukurinë e vet të përjetshme dhe ne fuqinë emocionale, përmes së cilës çdo pranues i artit hap horizonte të reja dhe krijon opinione që kurrë nuk janë menduar më parë. Kreativiteti është fuqia që mund të fshijë të kaluarën, të ndryshojë statukuonë dhe të gjejë potenciale të reja. Thënë thjesht, kreativiteti është një akt i fuqishëm. Artistët janë zërat e grupeve të margjinalizuara të shoqërisë – ata pasqyrojnë lidhjet shoqërore, kulturore dhe politike nga koha e tyre dhe sugjerojnë mënyra të reja dhe alternative për të ardhmen, që e inkurajojnë komunitetin të mendojë, luftojë dhe punojë për një të nesërme më të mirë. Arti krijon lidhje të pathyeshme ndërmjet atyre që e shijojnë atë dhe shkakton harmoni të pavetëdijshme të emocioneve që pasqyrohet tek të gjithë admiruesit e tij. Arti është gjithnjë në anën e mbështetjes, rezistencës, të vetëdijshmes dhe revolucionit. Arti është gjithnjë në anën e paqes dhe pajtimit.
Sashka J. (27)

Arti luan rol të rëndësishëm në kulturën e një shoqërie dhe mund të përfaqësojë një urë që lidh atë shoqëri me pjesën tjetër të botës. Unë do ta veçoja muzikën si degën e artit që është shfrytëzuar më shumë për arsye komerciale, pra, klishenë se muzika nuk njeh kufij. Duke gjetur një gjuhë të përbashkët, ju mund të përcillni mesazhe të rëndësishme nga dhe drejt anës tjetër. Mirëpo gabimi më i madh që mund të bëhet është të theksohet prejardhja etnike e performuesit. Pas një periudhe të caktuar të "shpërfilljes" së asaj të dhëne, ajo bëhet jorelevante dhe nuk përbën më problem. Duke e bërë këtë, theksi vihet tek performuesi dhe tek muzika (arti) e saj/tij. E njëjta shkon në drejtime të tjera, si fotografia, piktura, teatri etj. Theksi duhet vënë tek puna e saj/tij dhe jo tek prejardhja etnike.
Krsto B. (28)

Arti është medium përmes të cilit një person jo vetëm që shpreh kreativitetin e vet, por edhe çliron emocionet, shpresat dhe frikërat. Arti mund të jetë tekanjoz, përçarës, por mund të jetë edhe qetësues dhe frymëzues. Përmes interpretimit të artit, mund të arrijmë pajtimin duke parë nga këndvështrimi i dikujt tjetër. Të dalim jashtë këpucëve tona shpeshherë bën që të përballemi me realitetin. Kur konsumojmë art, kjo na bën të mendojmë në mënyrë kritike dhe të shohim përpjekjet e personit tjetër, duke na bërë që të kthehemi në mes të rrugës dhe të zgjasim dorën për paqe. Kjo mund të ndodhë për dy persona, dy grupe në konflikt e madje edhe për dy kombe. Sido që të jetë, arti mund të jetë i fuqishëm në kërkimin e tij për admirues.
Evgenija F. (25)

LAJME DHE RISI

HOLOKAUST NGA MIRJETA QEHAJA

@MirjetaQehajaOfficial

Mirjeta Qehaja, një artiste e re nga Kosova do të ketë ekspozitën e saj të dytë solo me piktura pranë Galerisë së Arteve të Universitetit të Prishtinës, në datat 3 – 16 dhjetor 2018. Me titullin "Holokaust", Mirjeta e përdor këtë referencë në pikturat e saj për të reflektuar për njerëzit e margjinalizuar dhe të shtypur në shoqëri, në mesin e tyre grupe të ndryshme etnike, persona me aftësi të kufizuara dhe komuniteti LGBTI. Artistja kërkon të "vendosë paralele ndërmjet gjendjes së racizmit në atë kohë dhe në kohën moderne që jetojmë tani" dhe "të nxisë kureshtje dhe njohuri të brezit të ri për diversitetin në Kosovë dhe në botë, si dhe ndryshime pozitive për ballafaqimin me situata të ndryshme ndëretnike".

EKSPOZITA DO TË SHFAQET NË GALERINË E ARTEVE TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS, 3 – 16 DHJETOR 2018.

ROLLING FILM FESTIVAL, EDICIONI I 5-TË, 13 – 16 NËNTOR 2018

Festivali Rolling Film u mbajt në datat 13 – 16 nëntor 2018, duke përmbyllur vitin e tij të pestë në përkrahje të shprehjes artistike rome. Ai synon të "kundërshtojë sterotipet njëdimensionale të 'ciganëve' në media, duke dhënë një pasqyrë më të pasur dhe më të plotë të romëve në familjet, punën, artin e tyre dhe të vendeve të ndryshme ku i ka dërguar rrota e tyre rrotulluese". Festivali është festë e romëve, ai ofron një hapësirë festive, dinamike dhe transformative. Festivali Rolling Film është i vetmi festival i filmit në Kosovë që përqendrohet tek rrëfimi i historive të komuniteteve rome në Kosovë dhe në mbarë botën. Përveç shfaqjes së mbi 150 filmave dhe krijimit të një databaze me më shumë se 400 filma, festivali ka përfshirë në programe për të drejtat e njeriut mbi 2,000 të rinj nga shkollat e mesme të Kosovës, ka prodhuar 56 filma të shkurtër përmes punëtorive të Cikore Filmja European Film dhe ka siguruar hapësirë për filmbërësit e rinj romë të Kosovës ku të krijojnë filmat e tyre të parë, për të cilët janë dhënë 5 çmime nëpër festivalet e Evropës.

BURIMI: ROLLINGFILMFESTIVAL.ORG / ROMA VERSITAS

DITA E SHIRITIT TË BARDHË
MESI ËSHTË MË I MIRË SE RONALDO.
EPO NUK MUND TË KRAHASOHEN, SIDOQOFTË MENDOJ SE RONALDO ËSHTË MË I MIRË.
ÇFARË PO NDODH KËTU?
NDONJË TAKIM MA MERR MENDJA, TA PYESIM DIKË...
NA FALNI, ÇFARË PO NDODH, ÇFARË TAKIMI ËSHTË KY?

MË 31 MAJ 1992, AUTORITETET SERBE TË BOSNJES NË PRIJEDOR DHANË PËRMES RADIOS LOKALE URDHËRIN QË POPULLSIA JOSERBE TË SHENJONTE SHTËPITË E VETA ME FLAMUJ APO CARSHAFË TË BARDHË. MAKINA ME ALTOPARLANTË DHE KORRIERË PËRCILLNIN URDHËRIN QË JOSERBËT ISHIN TË DETYRUAR TË BARTNIN NJË SHIRIT TË BARDHË RRETH KRAHUT PARA SE TË DILNIN NGA SHTËPITË. QË NGA VITI 2012, NISMA "SEPSE KA TË BËJË ME MUA" KA NISUR TA PËRKUJTOJË KËTË DITË SI "DITA E SHIRITIT TË BARDHË", SI SHENJË E LUFTËS NDAJ MOHIMIT TË KRIMEVE KUNDËR CIVILËVE KUDO NË BOTË ME NDËRTIMIN E NJË MEMORIALI QENDROR PËR 102 FËMIJËT E VRARË NDËRMJET VITEVE 1992-1995. NGJARJET NË PRIJEDOR NË ATË PERIUDHË JANË PËRSHKRUAR ME HOLLËSI GJATË GJYKIMEVE PRANË TRIBUNALIT NDËRKOMBËTAR PENAL PËR ISH-JUGOSLLAVINË (TNPJ). MË SHUMË SE 150 PERSONA JANË AKUZUAR PËR KRIMET E KRYERA NË PRIJEDOR DHE KUNDËR TYRE U INICUAN PROCEDURA PRANË TPNJ-SË DHE GJYKATAVE PENALE TË BOSNJE E HERCEGOVINËS. GJATË ASAJ PERIUDHE JANË VRARË OSE ZHDUKUR 3,176 CIVILË DHE TË BURGOSUR LUFTE DHE VARREZA MASIVE ENDE PO ZBULOHEN.

Milenko Bogdanoviq, ilustrator për stripa nga Prijedori.

A ËSHTË E MUNDUR TË FLITET PËR TË KALUARËN, POR NË TË NJËJTËN KOHË TË HESHTET PËR TË TASHMEN DHE TË ARDHMEN?

ELMA SELMAN

Elma Selman (1983) ka lindur në Prijedor (Bosnje dhe Hercegovinë) dhe aktualisht jeton dhe punon në kryeqytet, Sarajevë. Ajo u diplomua nga Fakulteti i Filozofisë (Departamenti i Psikologjisë) së Universitetit të Sarajevës. Teza e saj ishte “Marrëdhënia ndërmjet artit dhe psikoterapisë gjatë terapisë me art”.

AUTORË: ELMA SELMAN

Duke perifrazuar Idith Zertalin (Zertal, 1998), ne kurrë nuk ballafaqohemi me të kaluarën në vetvete, por këtë e bëjmë me formatet në të cilat ajo shfaqet dhe (keq)përdoret, që kryesisht janë të motivuara politikisht. E bëjmë me mënyrën se si ajo ndërthuret me të tashmen dhe si i jep formën të ardhmes. Duke patur këtë parasysh, është e pamundur që thjesht "ta lëmë të kaluarën në të kaluarën", gjë që shumë politikanë nga rajoni ynë e kërkojnë gjatë fushatave të tyre parazgjedhore apo në fjalimet e tyre të përditshme. Si është e mundur të mendosh për të ardhmen pa iu referuar së kaluarës? Këto referenca mund të jenë reagime direkte ndaj së kaluarës, së tashmes apo ndaj ngjarjeve specifike, madje edhe përpjekje për mohim dhe distancim të plotë nga e kaluara, me dëshirën për të krijuar një gjendje tërësisht të ndryshme sociale, ekonomike dhe politike (etj). Referenca është gjithnjë e pranishme.

Ballafaqimi me të kaluarën është proces gjithëpërfshirës që përmban metoda institucionale, veprime individuale dhe çdo lloj të veprimtarisë njerëzore. Një nga këto qasje është arti. Arti (ashtu si edhe "ballafaqimi me të kaluarën"), nëse marrim si shembull konceptin e Lojës së Gjuhës të Vitgenstinit (Wittgenstein, Philosophical Investigations, 2004), ka po aq përkufizime, sa edhe përpjekje për ta përkufizuar, si dhe kontekste brenda të të cilave ai mund të përdoret.

Atëherë, të luajmë një lojë (gjuhësore). Arti ka potencial politik për shkak të faktit se edhe arti, edhe politika, kanë të njëjtën sferë, janë dukuri që kërkojnë praninë e të tjerëve. Për shembull, arti performues zhvillohet në prani të shumë njerëzve, të një audience, qoftë në teatër, galeri apo hapësirë publike. Këtu edhe qëndron potenciali i tij. Shumëllojshmëria në sferat publike shërben si mbrojtje ndaj interpretimit të vetëm të së kaluarës që promovon ideologjia nacionaliste, duke dalluar dukshëm nga opinioni publik, që është konstrukt social i përgjithësimit. Gjatë procesit të ballafaqimit me të kaluarën, sfera publike bën të mundur që historitë jetësore individuale të ndahen me të tjerë dhe të përfshihen në diskutimet për ballafaqimin me të kaluarën, ku të kaluarës i jepet kuptim dhe si e tillë, kujtesë, që pastaj mund të përdoret si udhëzues për të ardhmen. E kaluara e Ballkanit Perëndimor interpretohet ndryshe dhe ka "të vërteta" të ndryshme, që shpeshherë janë në konflikt me njëra-tjetrën. Ideologjia nacionaliste krijon version uniform të së kaluarës, e riformëson sipas nevojave të agjendës politike dhe nuk lë pothuajse asnjë hapësirë për diskutime të hapura. Kështu, ballafaqimi me të kaluarën merr një drejtim tipik, ku viktimat dhe të mbijetuarit përdoren si objekte dhe karburant për të ruajtur sundimin e oligarkisë politike.

Të kesh mundësinë për të paraqitur një histori, opinion apo për të bërë një pyetje dhe që çdo pjesëtar në audiencë të mund të jetë dëshmitar, të ndërveprojë me të ose të preket prej saj, pavarësisht asaj që ai apo ajo sheh, ndjen dhe dëgjon, qoftë përmes përvojës së vet apo filtrit të përvojave, e bëjnë artin performues një mënyrë për ballafaqim me gjendjen e ndërlikuar socio-ekonomike dhe politike në të cilën jetojmë. Në Bosnje dhe Hercegovinë, ku e kaluara është e shumëpranishme, arti gjen mënyra për të procesuar, mënyra këto që na prekin, duke na mundësuar të "ballafaqohemi" me të kaluarën përmes qasjes dokumentare apo fiktive, duke na dhënë shpresë dhe dëshirë për të krijuar një shoqëri konstruktive me vullnet të investojë në një të ardhme "më të mirë", gjë që për momentin është veçse një frazë boshe.

Bazuar në përvojën time si autore dhe si pjesëtare e audiencës, unë kam gjetur tre qasje bazë me të cilat arti performues ballafaqohet me të kaluarën (të tashmen dhe të ardhmen).

Qasja e parë bën pyetje dhe kërkon nga elitat politike në pushtet të marrin përgjegjësi që gjatë periudhës së pasluftës e kanë penguar diskutimin e hapur për të kaluarën dhe e kanë manipuluar atë për agjendat politike. Duke e bërë të pamundur diskutimin publik për të kaluarën në praninë e turmës, arritja e mirëkuptimit dhe gjetja e kuptimit bëhen të pamundura, rrjedhimisht duke çuar drejt viktimizimit dhe objektivizimit të pjesëtarëve të shoqërisë. Më tej, kjo gjë kufizon mundësinë që kujtesa të përdoret si parim udhëheqës dhe në të vërtetë e shndërron atë në ushqyes për manipulime politike.

Qasja e dytë ka të bëjë në mënyrë specifike me viktimat dhe dëshmitarët e luftës së fundit dhe me mënyrën se si përvojat e tyre kanë ndikuar mbi brezat e lindur pas luftës. Si rezultat i objektivizimit, viktima pashmangshmërisht humbet subjektivitetin e vet, gjë që ka së paku dy implikime: njëri implikim është fakti se nëse përdoren si objekte ose shifra, viktimat lehtësisht mund të manipulohen dhe keqpërdoren për agjendat e lartpërmendura politike; ndërsa i dyti është fakti se objektivizimi i viktimave i pengon ata të jenë aktivë politikisht, duke patur parasysh se veprimtaria politike nënkupton veprim individual dhe marrje të përgjegjësisë. Arti performues mund t'i kontribuojë risubjektivizimit të viktimave, të të mbijetuarve dhe dëshmitarëve përmes hapësirës së sy-

nuar për histori jetësore që duhet të tregohen dhe ndahen në hapësirën publike. Nga njëra anë, kjo gjë i kontribuon procesit të shërimit të viktimave, të të mbijetuarve dhe dëshmitarëve dhe nga ana tjetër, iu ndihmon të pranojnë pozicionin e tyre si subjekt dhe si të tillë, janë në gjendje të jenë aktivë politikisht. Ky proces rezulton në empati dhe solidaritet, jo nga përgjithësimi apo uniformiteti i ideologjive nacionaliste, por më shumë nga pranimi i përvojave personale jetësore, që bashkërisht thonë diçka për ngjarjet e së kaluarës.

Qasja e tretë ngërthen distancën e dukshme nga e kaluara duke u kthyer drejt së ardhmes dhe duke e imagjinuar atë. Si do të donim të jetojmë? Çfarë do të na bënte të lumtur dhe të përmbushur në kontekstin shoqëror, ekonomik ose politik? Cilat vlera do të donim t'i bartim në të ardhmen? Këto pyetje dhe të tjera të ngjashme flasin edhe për atë që përjetojmë, çfarë kritikojmë dhe se si ndjehemi në këtë vend dhe shoqëri, si dhe marrin përsipër angazhim shoqëror të shkëlqyer që çel rrugën që kujtesa dhe përvoja të shërbejnë si udhëzues për të ardhmen.

Rishtazi, nxënësit e shkollës së mesme të Prijedorit krijuan një shfaqje teatrore të titulluar "Hajđekud". Ata shfrytëzuan qasjen pjesëmarrëse për të trajtuar temën e kujtimeve të së ardhmes. Qasja pjesëmarrëse mundësoi hapësirë dhe kohë për nxënësit që të përdornin të qeshurat, argëtimin, seriozitetin dhe përkushtimin për të eksploruar dialogun, për të inskenuar amnezinë grupore dhe individuale, për të treguar se si shoqëria i krijon marrëdhëniet me brezin e tyre dhe për të adresuar vlerat që ata duan të shtrojnë rrugën e tyre drejt së ardhmes. Autorë të pjesës ishin nxënësit. Procesi shfrytëzoi metodologjinë horizontale, ku mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme ishin fasilituesit të cilët, bashkë me pjesëmarrësit luajtën role që hapën tema që bënin fjalë për brezin e tyre, për marrëdhëniet me brezat më të vjetër dhe rolin e tyre brenda në shoqëri. Shumë gjëra nuk kujtohen, ndonjëherë thjesht sepse koha ecën, ose sepse është më e lehtë të harrosh. Ka tema që në Prijedor nuk harrohen, por nuk diskutohen. Gjatë përgatitjes për pjesën, 25 nxënës të shkollës së mesme të Prijedorit morën pjesë në punëtori për filma dhe lëvizje teatrore, zhvillim të skenarit, zërin, skenorgrafinë dhe kostumet, punë kjo që rezultoi në shfaqjen e titulluar me me shaka Hajđekud (shkurtesë për fjalët "Le të shkojmë! Ku? Në cilin drejtim?").

Arti dhe performancat pamore mund të shërbejnë si variacione të monumenteve të përkohshme dhe ato ngrihen vazhdimisht në një rajon ku memorializimi zyrtar është thjesht një tjetër burim konflikti ndërmjet ideologjive nacionaliste të ndryshme. Nëse analizohen nga këndvështrimi i shoqërisë konsumeriste, që kërkon rezultate të shpejta, deklarimet e mëhershme për fuqinë e artit dhe rolin e tij gjatë ballafaqimit me të kaluarën mund të tingëllojnë si tejet optimiste dhe të romanticizuara. Mirëpo, nëse analizojmë ndikimin nga këndvështrimi i veprimeve dhe reagimeve, ku "çdo veprim ka reagimin e vet dhe ku çdo proces është shkak për procese të reja" (Arendt, 1959), atëherë shpërfaqet potenciali i vërtetë i artit performues.

Arti fillimisht ndikon dhe ndryshon individët dhe shoqërinë në nivelin e ndërdijes dhe atë intim, më pas në nivel shoqëror dhe politik. Është shumë e vështirë të thuhet se deri në ç'masë ndodh kjo, mirëpo sigurisht që lë gjurmë dhe hap (të paktën) mikrohapësira për dialog. Kjo nuk mund të mohohet.

EMOCIONALJA MBI TË GJITHA

BORKA **PAVIQEVIQ**

Dramaturge dhe Drejtoreshë Artistike e Teatrit të Dramës në Beograd, Borkën e larguan nga puna për shkak të aktivizmit të saj publik dhe politik (1993). Themeluese dhe Drejtoreshë e Qendrës për Dekontaminim Kulturor në Beograd (që nga viti 1994). Dramaturge për teatrot në Zenica, Split, Shkup, Lubjanë, Suboticë dhe Beograd (1978-1991). Fituese e çmimit "Hiroshima Award" në vitin 2004 nga Fondacioni për Paqe dhe Kulturë, fituese e çmimit "Osvajanje slobode" në vitin 2005 nga fondacioni "Maja Maršićević Tasić", fituese e Urdhërit të Legjionit të Nderit të Republikës së Francës (2002) dhe çmimit "Ruts" në vitin 2009 nga Fondationi Kulturor Evropian (European Cultural Foundation).

Ajo që mua më duket se ka shumë rëndësi është gjuha që përdorim kur ballafaqohemi me të kaluarën, gjuha që përdorim në komunitetet që merren me "kujtesën". Kjo gjuhë kërkon një sërë termash të rinj. Gjuha e "koduar" ose e "projekteve" shërben vetëm për të zbrujtur dhe zhvleftësuar ndikimin e mesazhit. Fjalët nuk duhet ta "humbasin pafajësinë" (Sartri), në të kundërt i gjithë procesi i të menduarit dhe të vepruarit, si dhe mendimet dhe veprimet që rrjedhin më pas, shndërrohen në rutinë, duke dëmtuar vetë ato çështje për të cilat avokojnë. Ka shumë "korrupsion" në mënyrën se si flasim për kompleksitetin e shqyrtimit të perceptimeve dhe ndjenjave tona. Natyrshëm priremi t'i ndërlikojmë gjërat dhe jo t'i thjeshtojmë ato, sepse në të kundërt, kjo do të ishte dogmatizëm dhe kështu, refuzim i kuptimit "real". Pra, ne nuk mund të "përdorim" gjuhën e "kujtesës" ekzistuese, e sidomos nuk mund të përsërisim të vërtetat e rëndomta, as ndonjë gjuhë të koduar të komunikimit. Nëse veprojmë ashtu, ne i largojmë ata që do të donim të tërhiqnim dhe t'i nxisim për të gjetur gjuhën "e vet" për të hapur diskutime, për të mbushur zbrazëtira, për t'u konfrontuar dhe shoqëruar. "Komunitetet e kujtesës" krijojnë hapësira për shoqërim, të bazuara tek individë që nuk gjykojnë, por mendojnë dhe ndjejnë. Kur është fjala tek ballafaqimi me të kaluarën, gjuha e "zbutur" me kalimin e kohës shndërrohet në gjuhë konvencionale, pra, që nuk të ngjall emocion. Ka shumë moralizma në shoqëritë tona amorale.

Duke mos e njohur rolin e artit apo të kulturës në të drejtat e njeriut, në demokraci dhe në ekonomi për një kohë të gjatë, duke i theksuar ndërkohë këto vlera themelore, kohëve të fundit aleatët ndërkombëtarë dhe vendorë e kanë pranuar se në ato raste ku ligji dhe institucionet e tij nuk mund t'i fitojnë betejat në mënyrë të pavarur, arti dhe kultura mund të arrijnë atë çka ata nuk munden. Duke respektuar të drejtat e njeriut, pajtimim dhe duke krijuar siguri në jetët e qytetarëve. Arti ndërton ura. Ai ofron mundësi për katarsis dhe katarsisi mund të arrihet përmes prodhimit dhe shprehjes artistike.

Në fakt, neve na duhet të përcaktojmë se kush po pajtohet me kë. Dhe se kush është përgjegjës për luftën, dhunën, spastrimin etnik, gjenocidin, urbicidin, librocidin dhe kulturocidin. Sigurisht që këta persona nuk janë krijuesit dhe as aktivistët që kanë ngritur pikëpyetje kritike për ideologjinë e nacionalizmit si burimi i konfliktit dhe fatkeqësisë duke "kritikuar gjithçka

që ekziston" gjatë të gjithë viteve të luftës dhe pasluftës, kur lufta vazhdoi të bëhet me mjete të tjera. Nuk ka kuptim që të pajtohen ata që refuzojnë të pajtohen me ata që krijuan pamëshirshmërinë. Ata vepruan ashtu për të patur kontrollin e fuqisë njerëzore dhe të burimeve brenda "territoreve të tyre"; për të përcaktuar kufij që "të tjerët" nuk mund t'i kapërcejnë; për të luftuar kundër civilëve.

Sot është e vështirë t'i dëgjosh politikanët, analistët, priftërinjtë dhe ekspertët të flasin për rëndësinë e artit dhe kulturës për "kapërcimin e kufijve" dhe pajtimin.

Në fund të fundit, arti dhe kultura krijojnë tronditje dhe nuk e pranojnë gjendjen ekzistuese kur e turbullojnë. Udhëheqësit e kombeve, përfaqësuesit e identitetit dhe sovranitetit, që na sollën absurden, kiçin dhe këtë gjuhë "universale" të "denjësisë" dhe "tolerancës" duhet të përkujdesen që të sigurojnë lëvizjen e lirë të qyetarëve dhe sigurinë e tyre gjatë të vetmes jetë që kanë.

Ata jo vetëm që e bëjnë këtë me një gjuhë që ngërthen farat e së keqes dhe jo vetëm me mjete, por edhe me armë. Shtetësia, pashaporta dhe siguria për të gjithë ata që nuk i takojnë shumicës bien nën përgjegjësinë e qeverive të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe me gjithnjë e më shumë siguri kjo nuk vlen vetëm për Ballkanin "barbar". Dhe të gjithë propagandistët, ministrat e kulturës dhe figurat e tjera me autoritet, qoftë shpirtëror apo fizik, ideologjik ose formal, nuk duhet të deklarojnë se arti "ndërton ura". Ata nuk duhet të tentojnë të shmangin apo heqin qafe përgjegjësinë e tyre duke ia bartur atë artit dhe kulturës vetëm për të luajtur rolin e pajtimit. Arti ndërton ura duke vënë në pyetje fashizmin (epo, pak a shumë fashizmin) dhe "të drejtën" – këto nuk janë "tradita" të asociuara vetëm me "Ballkanin Perëndimor" apo "rajonin", mirëpo shtrihen, gjithnjë e më të fuqishme, gjithnjë e më katastrofike, në Evropë dhe në Amerikë, duke i shpallur luftë të drejtave të njeriut dhe lirisë së krijimit. Më të persektuar janë ata artistë që vënë në pikëpyetje "të vetin" dhe kanë legjitimitetin dhe pozicionin të vënë në pikëpyetje të gjithë "të tjerët". Shembujt janë të shumtë dhe shurdhues. "Hyjnorë", "skandalozë", "provokues", këta artistë akuzohen dhe etiketohen nga të gjitha anët.

Ata thonë se jetojmë në një botë post-faktike dhe jo vetëm për shkak se faktet janë ato që ne pajtohemi se janë. Ne gjithashtu i njohim ato si interpretime; ekzistenca e tyre krijon shpresën se diçka mund të provohet, se një dokument do të jetë diçka që do t'i bëjë qytetarët të ballafaqohen me vetë të kaluarën që ende e jetojnë në të tashmen. Kjo dukshëm nuk është thelb i i këtij procesi: i procesit të ballafaqimit me të kaluarën. Nuk ka siguri, nuk ka të vërtetë, nuk ka dëshmi kyçe që të çojnë drejt përmbysjes në emër të drejtësisë, traumës dhe viktimave. Që në asnjë rast nuk nënkupton se faktet nuk duhet të përsëriten dhe të përsëriten nga e para.

Emocionaliteti është ai që na sjell më pranë të kuptuarit, vetëdijësimi mund të sjellë paqe, ashtu si edhe solidariteti ndërmjet të gjithë atyre që e prishin paqen e agresorëve, të pajtuar në rezistencën e tyre. Emocionaliteti mbi të gjitha. Në këtë drejtim, arti është komuniteti i brendshëm i "kujtesës" dhe që përballet me humbjen dhe me madhështinë e njeriut. Ajo që na mungon, çdo ditë dhe gjithkund, është ndjesia dhe kapaciteti për madhështi dhe mrekullim. Kjo është diçka me të cilën duhet të përballemi.

Intervistë me Bojana Stojmenovskan, drejtoreshë e festivalit

SIMONA
ATANASOVA

In Situ është i pari festival ndërkombëtar i artit i këtij lloji në Shkup, ku artistë nga Maqedonia dhe bota mund të ekspozojnë punimet e tyre në tre seksionet e programit – artet pamore, dizajni dhe arkitektura.

Drejtoresha e festivalit Bojana Stojmenovska thotë se ky festival u jep individëve mundësinë që të ballafaqohen me të kaluarën duke përdorur hapësirën, audiencën dhe kontekstin që u ofron ekspozita, pët të mundësuar trajtimin, komunikimin dhe ndërveprimin për temën.

Këtë vit, ekspozita u mbajt në datat 13 – 15 shtator në Qendrën Kulturore të Rinisë (MKC) dhe aty u shfaqën punime nga mbi 100 autorë.

Si ju lindi ideja për të organizuar një fesival të tillë? Çfarë ju nxiti dhe si u zhvillua ndër vite?

Kur nisa të merrem me organizimin e këtij festivali, e kuptova se një nga tiparet e Shkupit ishte tendenca e tij për t'i ndarë gjërat në vend se t'i bashkonte. Ka shumë përmbajtje, mirëpo ndonjëherë një person nuk mund ta gjejë atë përmbajtje në një vend të vetëm. Për të duhet kërkuar dhe kjo është theksuar gjithnjë e më shumë. E kuptova pra, se kishte potencial për të bërë diçka lidhur me këtë dhe pikërisht atëherë filluam me përvojën e mirë të Paratissima-s në Torino (2014) dhe e replikuam ekspozitën e tyre këtu, si një shembull të suksesshëm të krijimit të një skene të vetme homogjene që do të rritej më tej natyrshëm. Pati mjaft skepticizëm nga të gjithë ata që u ftuan për bashkëpunim. Ata më thanë se ishte e pakuptimtë, se nuk mund të bëhej. Ndonjëherë madje i thoja dhe vetes se po përqafoja diçka krejtësisht të marrë dhe nga ana tjetër, përballesha me sulme të befta nga një lloj smire dhe sfide, sepse e përjetoja si provokim. Ne kemi prirjen të kritikojmë gjatë të gjithë kohës, mirëpo askush nuk përpiqet të ndryshojë diçka. Opinioni mbizotërues është se asgjë nuk mund të bëhet, a thua se jetojmë në ndonjë vend të shkëputur nga bota, mirëpo në fakt ka shumë njerëz që kanë qëllime të sinqerta dhe interesim për të kontribuar që diçka të dalë ndryshe. Në fillim, u konsiderua si një ngjarje alternative, ku mblidheshin njerëzit e lidhur me artin dhe të keqkuptuar nga shoqëria, mirëpo evoluoi në një ngjarje ku mund të gjeje gjëra të reja, talente dhe njerëz të rinj.

Cili është qëllimi kryesor i festivalit dhe cili është mesazhi që doni të dërgoni? A mendoni se ky mesazh arrin tek audienca?

Mesazhi që duam të përcjellim, sidomos në Maqedoni, është se të zhvillosh një konkurrim është diçka fantastike, mirëpo përgjegjësia kolektive në çdo sferë dhe sidomos në këtë sferë është thelbësore për të rritur standardin se si paraqiten gjërat dhe se si kjo i komunikohet audiencës dhe se si potencialët dhe inovacionet e reja po nxirren në sipërfaqe të gjithçkaje që ne bëjmë. Ne dërgojmë mesazhin se është krijuar hapësirë dhe kohë ku duhet ta dëshmojmë se është e mundur dhe se funksionon dhe se nga tani e tutje duhet të jetë diçka që e kultivojmë. Mirëpo, nuk do të doja që ta shihja këtë të kultivohej si diçka më vete apo në vetvete, do të doja të shihja që ky zhvillim të përfshijë të gjithë ata që mendojnë se kanë diçka për të kontribuar. Sinqerisht mendoj se mesazhi e ka prekur audiencën.

Përse këto festivale shumëkulturore kanë vështirësi me tërheqjen e artistëve nga Ballkani?

Mendoj se në përgjithësi, ne si ballkanas kemi prirjen ta nënvlerësojmë njëri-tjetrin dhe mendimi mbizotërues është se gjithçka që vjen nga Perëndimi apo nga jashtë Ballkanit është më e mirë se ajo që mund të arrihet në Ballkan dhe se asgjë që bëhet këtu nuk mund të krahasohet me ndonjë skenë tjetër. Fakti është se kemi burime të kufizuara dhe se kemi mbetur prapa në shumë gjëra që nuk janë të ndërlidhura me atë se a mund të bashkëpunojmë apo jo. Kam përshtypjen që ne e shmangim njëri-tjetrin, se duam të shkojmë diku më larg duke menduar se dikush është më i mirë dhe di më shumë se ne. Sipas përvojës sime, mund të them sinqerisht se nuk ka ndonjë dallim në cilësinë dhe seriozitetin dhe profesionalizmin e autorëve dhe skenave maqedonase, ballkanase dhe të tjera. Ka lloje të ndryshme të shprehjes apo mjete të ndryshme të shprehjes apo formulim disi më ndryshe. Në disa pjesë, mund të jetë më i guximshëm apo tjetërsoj, sepse kushtet janë të ndryshme, mirëpo ne nuk jemi as më pak të aftë, as të prapambetur sa i përket asaj që kemi për të ndarë. Në Ballkan, kemi pothuajse të njëjtat probleme që dallojnë pakëz nga vendi në vend dhe nëse dhe kur do të kishte ndonjë aleancë në këtë drejtim, mendoj se skena ballkanike do të dilte në sipërfaqe shumë më shpejt. Mirëpo secili e sheh problemin e vet si më të madhin dhe mendojnë se askush nuk mund t'i kuptojë.

Si ndikon arti tek ballafaqimi me të kaluarën?

Mendoj se është më i theksuar në Ballkan, pasi për shkak të shpërbërjes së Jugosllavisë dhe ndarjes së vendeve, ne kemi një të kaluar kolektive dhe të përbashkët që mund të mos jetë shumë e theksuar në këto breza, por që gjithsesi ende trashëgohet nga brezi në brez, sidomos përmes kujtimeve të së kaluarës. Mendoj se këto lloj ngjarjesh ndihmojnë, sidomos në ballafaqimin me gjërat që duhet të perceptohen si të ndryshme, kur bashkohemi në një hapësirë dhe kur takohemi në një vend dhe kohë të caktuar, ato më nuk janë dallime, por përparësi. Mendoj se për çdo vend të Ballkanit Perëndimor, ballafaqimi me të kaluarën është i vështirë, sidomos pasi rrethanat janë të ndryshme. Megjithatë, mendoj se këto stereotipe dhe keqkuptime tejkalohen shumë lehtë kur trajtohen në ngjarje të tilla, sepse atmosfera është joformale, ka të bëjë me diçka që është estetike dhe ekziston në kontekst të zhvillimeve politike të përditshme, edhe pse shumë prej autorëve natyrisht që me punimet e tyre transferojnë interpretimet e tyre politike dhe kombëtare dhe gjinore. Në përgjithësi, ata trajtojnë të njëjtat pyetje ekzistenciale, me të njëjtat shqetësime, në të njëjtin kontekst global. Në festival, ata shoqërohen me njëri-tjetrin, nuk ka barriera gjuhësore, nuk ka patur asnjë lloj problemi.

NGA: IN SITU

NGA: IN SITU

Përse skena e artit në Maqedoni nuk ofron ballafaqim me të kaluarën?

Mendoj se e ofron, mirëpo mendoj se e ofron në mënyrë të ndryshme. Pikëpamja ime është se nuk duhet të trajtohet në mënyrë sipërfaqësore, se adresimi i çështjes dhe trajtimi i saj në kuadër të kulturës dhe artit duhet të jetë diçka që mbështetet nga hulumtimet, nga ballafaqimi që duhet të mbulojë shumë vite më parë, në mënyrë që kur t'i vijë afër fundit, të sjellë rezultate të qarta. Çdo trajtim sipërfaqësor i problemit të ballafaqimit me të kaluarën pritet të tërheqë më shumë probleme se sa t'i zgjidhë ato. Arsyeja duhet të jetë a thua se sektori i kulturës dhe artit nuk merret me këtë temë, sepse është proces hulumtues dhe fillon nga eksplorimi i vetes, pra nga vetëdijësimi dhe pastaj lëviz drejt dikujt tjetër dhe më pas lëviz nga një kolektivë e vetme drejt një tjetër kolektive. Tema është shumë komplekse për të qenë e zakonshme. Nuk po them se nuk duhet të ndodhë më shpesh, por mendoj se duhet të trajtohet me vëmendje të posaçme, sepse jam e sigurtë që perspektiva personale nuk duhet të jetë ndërhyrëse, por duhet të jetë më shumë e hapur se sa e mbyllur. Ballafaqimi me të kaluarën duhet të jetë në përputhje me ballafaqimin me të ardhmen. Duhet të jetë diçka e mbështetur nga procesi i të menduarit thelbësor, jo vetëm për diçka që është thënë ose ekspozuar dhe vetëm është paraqitur, pasi kjo në vetvete është sipërfaqësore dhe krijon më shumë konfuzion se sa të ofrojë ndonjë lloj të ballafaqimit.

Si do ta ndryshojë festivali këtë gjendje?

Mendoj se e ndryshon, sepse sa i përket asaj se kush paraqet këtu punimet e veta, ne nuk kemi proces të përzgjedhjes së autorëve, pavarësisht gjinisë, moshës së tyre, formatit, temës së shprehur, vendit të origjinës. Festivali u ofron individëve mundësinë që të përballen duke përdorur hapësirën e ofruar nga ekspozita, kontekstin dhe audiencën, për të mundësuar trajtimin, komunikimin dhe ndërveprimin për këto tema. Hapja absolute, që është një tipar demokratik i ekspozitës, ofron hapësirën e duhur për të gjitha këto çështje të vetështjelluara që janë thelbësore për të gjithë. Trajtimi i së kaluarës është diçka që mendoj se duhet të jetë nismë personale. Ne punojmë me shumë vullnetarë. Vitin e kaluar patëm 70 vullnetarë që ishin atje për t'i asistuar gjithkujt që merrte pjesë në ekspozitë si të gjendeshin, duke ndihmuar në krijimin e shumë miqësive.

Si e vlerësoni skenën kulturore dhe artistike në Maqedoni?

Mendoj se në përgjithësi, Maqedonia nuk është mjaftueshëm e zhvilluar, pasi një pjesë e madhe e ngjarjeve janë të centralizuara në Shkup. Ka një numër të pamjaftueshëm të ngjarjeve jashtë Shkupit dhe mendoj se ngjarjet jashtë Shkupit janë të suksesshme dhe kjo vetëm sa dëshmon se kanë nevojë për më shumë organizime. Nuk ka shumë komunikimin ndërmjet organizatave që merren me kulturë dhe art dhe ka njëfarë rezistence, për shkak të konkurrencës ose padijenisë. Mirëpo mendoj se në 4-5 vitet e fundit ka patur progres të jashtëzakonshëm sa i përket cilësisë dhe sasisë. Sa i përket cilësisë, mendoj se kemi shumë hapësirë për të mbushur. Kjo nuk do të thotë se çka ka aktualisht në treg nuk ka cilësi, përkundrazi, ka cilësi. Mirëpo për shkak të mungesës së burimeve dhe si rezultat i izolimit të imponuar pjesërisht nga vetja dhe pjesërisht nga faktorë të jashtëm, ka më pak eksperimentime dhe më pak inovacion se sa do të doja personalisht të shihja. Kam përshtypjen se ndonjëherë është relativisht uniform, edhe pse kjo gjë nuk e ul cilësinë e asaj që paraqitet. Mua më mungojnë paraqitjet eksperimentale, sidomos duke patur parasysh teknologjinë e zhvilluar, që nuk mendoj se është e parritshme apo problematike për t'u zhvilluar. Mendoj se njerëzit janë shumë të preokupuar me zhvillimet politike dhe kjo i largon ata nga kreativiteti. Arti ka qenë gjithnjë një mjet që ka përparuar më së shumti gjatë kohërave të rënda dhe në rrethana të vështira dhe më pak në kohëra të prosperitetit.

FUQIA E ARTIT PËR BALLAFAQIMIN ME TË KALUARËN

Dardan Hoti

Një prej sfidave më të mëdha sot mbetet trajtimi i duhur i çështjeve të ndryshme që prekin thelbin e shoqërisë. Kur e kaluara mbyllet në sirtarin e historisë, e tashmja rëndohet dhe nuk ka vend për ndryshime. Shpeshherë, kjo ndodh si rrjedhojë e ndërhyrjes së politikës, të cilës i konvenon që historia të shkruhet sipas interesave të caktuara.

Në rastin e Kosovës, tema të tilla mbahen të heshtura si rezultat i mosngritjes së zërit, stigmës apo edhe mentalitetit. E kur duket se të gjitha rrugët janë mbyllur, është arti ai që mund të bëjë ndryshimin. Një gjë e tillë tashmë është dëshmuar gjithandej në botë, por edhe në Kosovë. Pasojat e luftës së fundit - e cila pas vetes la mijëra njerëz të vrarë, shtëpi të djegura e të shkatërruara, viktima të dhunës seksuale, një ekonomi tërësisht të shkatërruar – tash e gati dy dekada ende vërehen. Si formë e tejkalimit, ose ballafaqimit me një realitet që ka ndodhur, shpeshherë është përdorur arti.

Një shembull i mirë në këtë drejtim është instalacioni i artistes kosovare e cila jeton në Londër, Alketa Xhafa-Mripa. "Mendoj për ty" e realizuar në vitin 2015 në stadiumin e Prishtinës, ngriti një prej temave më të ndjeshme për shoqërinë kosovare të pasluftës. U dha zë atyre që për shumë vite qëndruan të heshtura: trajtoi temën e viktimave të dhunës seksuale në Kosovë. Me mbledhjen e fustaneve nga vetë viktimat, të cilat për herë të parë nuk u paragjykuan për një "krim" që nuk e kanë bërë, por edhe të fustaneve që të tjerët i dhuruan në shenjë solidarizimi, bëri që mbarë bota të flas për to. Në këtë rast, jo vetëm shoqëria kosovare hapi sytë për një çështje shumë të ndjeshme, por zëri i këtyre grave u dëgjua edhe më tej.

Xhafa-Mripa është vetëm një prej artistëve e cila përmes platformës së saj artistike ka arritur të prekë tema të tilla, shumë të rëndësishme. Këngëtarja, arkitektja e njohur kosovare Eliza Hoxha, është një tjetër shembull në këtë mes. Rishtazi ajo prezantoi Kosovën në Bienalen e Arkitekturës në Venecia me instalacionin "Qyteti është gjithandej". Hoxha gërshetoi aspektin arkitektonik dhe artistik në Pavijonin e Kosovës, në prezantimin që solli në retrospektivë të kaluarën historike të vendit. Në thelb, ajo preku vitet '90, kur në vend zhvillohej sistemi paralel i arsimimit.

Autori: Korab Krasniqi

Për të, platforma e shprehjes artistike (cilado qoftë ajo) është shumë e rëndësishme për të adresuar çështje të ndryshme shoqërore, qofshin ato nga e kaluara, tema tabu apo edhe problematika të tjera të theksuara në shoqëri.

"Shpeshherë në këtë kontekst, arti në mënyrë shumë të butë dhe të paimponuar hap debat apo edhe krijon një strehë të re për të kaluarën, për dhimbjen dhe për të pathënat e shumta që vijnë si pasojë e mentalitetit shoqëror. Sepse artistët në shumë raste prekin çështje për të cilat shoqëria shpesh nuk është gati për të folur dhe vepruar", thotë Hoxha, e cila gjatë dy dekadave të fundit ka ngritur përmes artit të saj edhe çështjen e personave të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë, e po ashtu ka bërë edhe një projekt për gratë e dhunuara.

"Kur jemi te ky i fundit - procesi i projekti ka zgjatur dy vite - si hulumtim dhe si diskutim me akterët, në mënyrë që të kuptohet çështja në thelb dhe gjithmonë me shumë kujdes rreth ndjeshmërisë së madhe që ka tema. Dhe në kohen kur shoqata të shumta po punonin ndër vite me këto gra, por nuk po flisnin publikisht, ky projekt thyen heshtjen dhe hap derën për shumë ngjarje të reja publike në lidhje me këtë çështje", thotë Hoxha. Sipas saj, arti shërben dhe në të njëjtën kohë ndihmon në procesin e ballafaqimit me të kaluarën, duke e memorizuar kështu atë në një format më kreativ. Hoxha thotë se e kaluara është e rëndësishme për të reflektuar dhe për t'u çliruar nga shumë pikëpyetje individuale dhe kolektive. Efektet e saj mund të jenë të ndryshme.

"Ndonjëherë të thyej tabu, ndonjëherë të hap debat, ndonjëherë të shtyj një proces tutje, ndonjëherë të bëhem zëri i të margjinalizuarve, ndonjëherë të mobilizoj e të sensibilizoj, ndonjëherë të regjistroj e të memorizoj e të tjera", thotë Hoxha, e cila vetëm një muaj më parë me një ekspozitë të saj u bë pjesë e një festivali i cili mbahet në Beograd, e që për qëllim kryesor ka ballafaqimin e dy popujve: shqiptar dhe serb, me të kaluarën. Përkundër faktit se janë trajtuar shumë tema sa i përket historisë së viteve '90, është e qartë se ende ka shumë për t'u bërë në këtë drejtim. Ndalimi i Hoxhës në kufi kur po udhëtontebashkë me ekipin e festivalit "Mirëdita, dobar dan" dhe pas konfiskimit të disa prej fotografive të saj, është tregues i mirë i kësaj gjendjeje. Pak ditë më parë, pothuajse të njëjtin fat e pati edhe kritiku i artit dhe analisti Shkëlzen Maliqi, të cilit iu ndalua hyrja në Serbi. Ai ishte nisur atje për promovimin e një monografie që përmbledh 20 vjet të bashkëpunimit artistik ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, por që përqendrohet në ekspozitën e vitit 1997 "Përtej", të cilën Maliqi e kishte hapur për herë të parë në Beograd bashkë me katër artistë kosovarë. "Arti mund të përdoret dhe të shfrytëzohet si mjet, por atëherë është në rrezik të bëhet mjet i propagandës, t'i shërbejë ideologjive dhe politikave etj., duke u vetëdegraduar, madje edhe kur kjo arsyetohet me 'qëllime të mira'", ka thënë Maliqi. Sipas tij, arti nuk shfrytëzohet për t'u ballafaquar me të kaluarën, por arti e përdor të kaluarën, sikur edhe temat tjera, si "medium" për realizimin e veprave, artefakteve. "Atë çka e bën historia ose morali duke shpjeguar

Eliza Hoxha, gjatë prezantimit të Kosovës në Bienalen e Arkitekturës në Venencia me instalacionin "Qyteti është gjithandej"

Autore: Majlinda Hoxha – Fotografe zyrtare e Pavionit të Kosovës

të kaluarën, nuk ka pse ta bëjë arti, sepse shndërrohet në ilustrim. Arti synon më thellë, unikalitetin kompleks të ndodhive të së kaluarës ose të së sotmes, edhe në dimensionet që nuk janë njohje dhe mësim, por që janë përjetim sublim i tërësisë së situatave jetësore. Këtë përjetim Aristoteli e ka quajtur katarsis, ose trandje, shok të të kuptuarit / moskuptuarit të misterit të jetës me aspekte që mund të jenë njëkohësisht tragjike, lumturuese, komike etj...", thotë Maliqi.

Krahas shprehjes artistike përmes fotografisë, instalacionit apo edhe artit pamor, një formë tejet e rëndësishme në këtë mes është edhe teatri. Dramaturgu i njohur kosovar Jeton Neziraj, tashmë ka realizuar disa drama përmes të cilave preket edhe e kaluara. Ai thotë se kur dramat e tilla bëhen publike, qoftë si botime apo si inskenime, ato në një formë e ballafaqojnë publikun me të kaluarën që trajtohet aty. Për të, ballafaqimi "artistik" është shumë i rëndësishëm. "Natyrisht, madje, do të thosha që format e shprehjes artistike, të cilësdo disiplinë të artit, ngelen mediumet më efikase për t'u ballafaquar me të kaluarën. Por sidomos teatri. Sepse, teatri natyrisht nuk e pretendon të vërtetën, ose, të themi, e pretendon "të vërtetën artistike". Teatri shtron pyetje dhe kur këto pyetje kanë të bëjnë me të kaluarën, sidomos me atë të kaluar e cila është e pazbardhur si duhet, e kamufluar me mite, e ngarkuar me të pavërteta, e mbingarkuar me lavdi të rrejshme, me krime për të cilat askush nuk guxon të flasë, e kështu me radhë", thotë Neziraj, i cili një gjë të tillë e bën në dramën "Carla Del Ponte pi Vanilla Chai Latte në Prishtinë" apo "Një shfaqje teatri me 4 aktorë…", "Bordel Ballkan" e të tjera.

"Atëherë teatri bëhet ai forumi i domosdoshëm që duke shtruar pyetje, synon ta 'pastrojë' shoqërinë nga ajo e kaluar dhe njëherazi ta vetëdijësojë për të ardhmen. Pra, duke ia kujtuar të shkuarën, teatri synon ta përmirësojë shoqërinë, ta bëjë më humane, ta bëjë më tolerante, në mënyrë që e kaluara të mos përsëritet", thotë Neziraj. Kjo dëshmon se arti ka fuqinë ta vetëdijësojë shoqërinë për të kaluarën, në mënyrë që ajo të mos përsëritet. Një e kaluar "problematike" në këtë rast, të cilën shoqëria shpesh e shtyp, e fsheh e me të cilën nuk ka fuqi të ballafaqohet.

Fushata për pajtimin e gjaqeve

1990-1991

Historia orale dhe kujtesa

E SHFAQUR NË GALERINË E ARTEVE NË PEJË, 25 PRILL - 21 MAJ 2018

ERËMIRË KRASNIQI, ORAL HISTORY KOSOVO

Fushata për pajtimin e gjaqeve:
Fushata për pajtimin e gjaqeve nisi në vitin 1990 si thirrje për bashkim ndërmjet shqiptarëve të Kosovës. Ndërsa Millosheviqi merrte fuqi, Kushtetuta e vitit 1974 u shfuqizua, duke e bërë Kosovën të cënueshme brenda asaj që ende konsiderohej si hapësirë jugosllave. Fushata pati rol emancipues, pasi bënte thirrje për bashkim dhe falje dhe i ftonte njerëzit të ripozicionoheshin politikisht. Ajo vinte në dukje se si kodi i nderit të shqiptarëve ishte keqpërdorur për t'i portretizuar shqiptarët si popull më pak i qytetëruar përbrenda Jugosllavisë.

Qëllimi ishte që të gjithë njerëzit e arsimuar t'u qaseshin komuniteteve të tyre dhe t'i inkurajonin familjet të falnin gjakmarrjet, me theksin tek përfshirja e studenteve vajza në këtë proces. Procesi i ndërmjetësimit zakonisht bëhej nëpër oda, kur deri në atë kohë, gratë nuk ishin lejuar të hyjnë. Në shumë mënyra, fushata delegjitimizoi autoritetet që ruanin kodin e nderit dhe u mundësoi njerëzve të mendonin sërish për atë se si e kuptonin kodin e nderit brenda komuniteteve të tyre.

Shqiptarët që jetonin në diasporë e merrnin me vete kodin e tyre të nderit dhe asnjëherë nuk i kishin falur gjakmarrjet, derisa një delegacion i pajtuesve nga Kosova, me në krye Anton Çettën u ftuan në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përkatësisht në Nju Jork dhe Detroit, për të pajtuar familjet.

Foto nga: Ekspozita për fushatën e pajtimit të gjaqeve 1990-1991 që u mbajt nga 25 prilli deri me 21 maj 2018, në vendlindjen e fushatës, në Pejë (Oral History Kosovo)

Procesi i ndërmjetësimit zakonisht bëhej nëpër oda, kur deri në atë kohë, gratë nuk ishin lejuar të hyjnë. Në shumë mënyra, fushata delegjitimizoi autoritetet që ruanin kodin e nderit dhe u mundësoi njerëzve të mendonin sërish për atë se si e kuptonin kodin e nderit brenda komuniteteve të tyre.

Rezultati ishte me mijëra pajtime dhe çlirimi i familjeve nga detyra e përcaktuar me kodin e nderit: të merrnin hak dhe të nxirrnin gjak. Akti i faljes siguronte një shkallë të sigurisë në hapësira publike brenda komuniteteve më të vogla në Kosovë, që në atë kohë mungonin për shkak të regjimit të Millosheviqit. Ndikimi i fushatës ishte aq i gjerë, saqë edhe njerëzit në diasporë e përcillnin më vëmendje dhe falnin gjakmarrjet atje.

Si mund të përdoret sot si shembull kjo fushatë?

Fushata për pajtimin e gjaqeve është një histori e shkëlqyeshme, nga e cila mund të nxjerrim shumë mësime të rëndësishme, ndër to për faljen, nderin dhe solidaritetin. Kjo histori mishëron vlera dhe procese kulturore që në vetvete ngrenë pyetje për çdo kohë – këto jo detyrimisht kërkojnë vëmendjen tonë sot, por mund t'u kthehemi vazhdimisht, kur mendojmë se nga çfarë përbëhet ndjenja jonë e humanitetit dhe cilat janë vlerat themelore që e mbajnë të bashkuar këtë komunitet.

Elementi ndërfetar sërish po shndërrohet në shqetësim në këtë rajon, një shqetësim ky që duhet trajtuar me kujdes. Fushata për pajtimin e gjaqeve është mbështetur fuqishëm mbi paradigmën e zgjimit kombëtar të shekullit të 19-të "feja e shqiptarit është shqiptaria" dhe pikërisht këtë është përpjekur të paraqesë gjatë viteve 1990: bashkimi mbi të gjitha, duke e vënë theksin tek gjuha shqipe si përbërësi homogjenizues i kombit.

Ajo inkurajon zgjidhjen që është e thjeshtë, por e vështirë për t'u arritur, vendos vlerën tek ajo që na bën bashkë dhe jo tek ajo që na ndan.
Kjo zgjidhje është e ndërlidhur me kontekstin dhe për këtë arsye është e suksesshme, mirëpo nuk shoh se si mund të përkthehet në kontekste të tjera kulturore dhe kjo ndodh pasi shumica e vendeve të Ballkanit i kanë homogjenizuar identitetet e tyre kombëtare rreth fesë dhe jo rreth gjuhës dhe shpeshherë, feja shndërrohet në bazën e përjashtimit në kontekste ku feja ka prioritet mbi kulturën.

Organizimi i projektit

Aktivistët dhe anëtarët e familjeve që kanë dhënë faljen ishin në qendër të narrativës së ekspozitës. Në fazën e kurimit të projektit, ishte me rëndësi që të shmangej glorifikimi apo lartësimi i disa figurave të caktuara njerëzore, si edhe dimensioni përkujtimor që është qasja e zakonshme në ekspozita.
Këto vendime të kuratorit nuk duhen parë si mungesë respekti ndaj protagonistëve kryesorë të fushatës, por si një mënyrë për t'i dhënë historisë pamjen humane dhe për ta hapur atë për histori të tjera, për nën-fabula dhe nën-personazhe. Jam përpjekur të krijoj më shumë hapësirë për protagonistët e harruar; gratë kanë qenë vendimtare për lëvizjen dhe edhe pse janë në qindra fotografi nga fushata e pajtimit, disi askujt nuk i kujtohen emrat e tyre dhe vështirë që dikush të ketë ndonjë histori me gra në të.
Dhënia fund e dimensionit përkujtimor të ekspozitës ishte zgjidhje që kishte të bënte me mënyrën se si unë e kuptoj historinë bashkëkohore; historitë që ne kujtojmë dhe me të cilat ndërveprojmë dhe ushqejmë pikëpamjet e botës së sotme.
Unë nuk i përjetoj si diçka statike, ndaj është e pamundur t'i monumentalizoj në një narrativë të vetme dhe të ndërtoj kujtesën dhe përvojën nga një pozicion i vetëm.
Natyra e gabueshme dhe e papërcaktuar e vetë kujtesës është pasqyruar në narrativën e ekspozitës dhe në zgjidhjet kuratoriale që krijova.

NGA: ORAL HISTORY KOSOVO

Ndërtimi i komunitetit të kujtesës

Ishte e rëndësishme që të ndërtoja një komunitet të kujtesës. Mendoj se e kemi arritur. Ditë pas dite, ekspozitën e vizitonin njerëz që ishin pjesë e fushatës, por të cilët, si nismë e Historisë Orale, një ekip i vogël, nuk patëm rastin t'i takojmë. Mirëpo hapësira e ekspozitës u shndërrua në një vendtakim, ku ata mund të shfletonin Librin e Fotove, një album me fotografi që i mblodhëm nga të gjithë njerëzit të cilët intervistuam. Këto takime na sollën histori të tjera dhe vende për pajtim.

Intervistat për historitë orale

Metodologjia e intervistimit për histori orale është proces ku ndërthurren subjektet, ku intervistuesi dhe folësi hyjnë në një proces të bashkëproduksionit. Rrëfimi është pjesë e rëndësishme e procesit të intervistimit. Si intervistuese, unë ekspozohem ndaj rrëfimeve dhe imazheve dhe këto pikëpjekje personale shndërrohen në një mënyrë të prodhimit të njohurive për komunitetin tonë. Sigurisht, ajo çka ti mendon si hulumtues apo kurator është si të krijosh një mjedis për narrativën dhe t'u mundësosh të tjerëve të gjallojnë në këto hapësira. Gjatë projektimit të hapësirës së ekspozitës që mbështetet tek hulumtimi, shqetësimi kryesor nuk është të ngarkosh publikun me shumë infomacion, por të kesh mjaftueshëm informacion për të mbajtur gjallë kureshtjen dhe dëshirën për zbulime.

Arti dhe e kaluara

Me raste, unë përdor strategji kuratoriale që tradicionalisht konsiderohen të zakonshme në botën e artit, por të pazakonta për një ekspozitë për historinë. Këtu, arti ndihmon për të përcjellë informacion të ngjeshur, duke thënë shumë me më pak.

Po ashtu, strategjitë e artit përmbajnë njëfarë shkalle të pasigurisë, sepse vlerësojnë procesin e prodhimit dhe ndonjëherë këtë e bëjnë duke mbuluar pyetjet e vështira dhe duke i përcjellë ato përmes strategjive që vijnë nga bota e artit, papritmas disa pyetje humanizohen dhe bëhen të vetëdijshme për papërsosmërinë e tyre.

Ta pranosh këtë në një mjedis ekspozues mendoj se është shumë me rëndësi, sepse e bën ekspozitën një hapësirë performuese ku publiku mund të prodhojë po aq njohuri.

Arti dhe kultura si mjete për t'u angazhuar me të kaluarën?

Në rajonin tonë, pyetjet që kanë të bëjnë me të kaluarën janë gjithnjë të vështira. Strategjitë kuratoriale që shfrytëzohen e paraqesin përmbajtjen në atë formë që i mban pyetjet e hapura për diskutim dhe lë hapësirë për më shumë se sa një narrativë. Për ta bërë këtë, kultura dhe ajo çka nxjerrim prej saj na ndihmon të kuptojmë kontekstin tonë brenda të cilit veprojmë. Sigurisht, kjo ushqen ndjenjën time të përgjegjësisë ndaj narrativës që po përpiqem të kuroj. Qasja ime kuratoriale është mjaft ndërdisiplinore, ndaj nuk arrij t'i shoh qartë këto ndarje disiplinore. Unë lejoj hulumtimin të më udhëheqë gjatë punës si kuratore. Përpiqem të trajtoj nevojat e përmbajtjes me të cilën po punoj. Përmbajtja e hulumtimit dikton mënyrën se si paraqitet diçka. Sidoqoftë, të gjesh një mënyrë për të shpalosur materialin që përputhet me hulumtimin dhe që arrin të theksojë aspektet e rëndësishme të hulumtimit, sigurisht që ky dimension është vizual, e megjithatë, është i ndërlidhur intimisht me përmbajtjen, është shumë i rëndësishëm, sepse pavarësisht se çfarë fasiliton apo jo mënyra se si paraqitet përmbajtja: marrëdhënien ndërmjet publikut dhe vetë hulumtimit.

Reagimet ndaj ekspozitës

Çdo ekspozitë muzeale përpiqet të jetë një mundësi për foto të vetvetes (selfie), ku vizitorët bëjnë fotografi dhe i postojnë ato në rrjet. Ekspozita kishte një mur qendror, me një fotografi të madhe nga takimi për pajtim në Nabërgjan, një fshat në komunën e Pejës. Fotografia tregonte një turmë të madhe njerëzish që shikonin në drejtim të njerëzve të cilët supozojmë po pajtoheshin, meqë nuk e shohim se çfarë po shikojnë, mirëpo situatën e lexojmë duke vështruar fytyrat e tyre.

E kam zgjedhur atë fotografi, sepse pasqyron të qenit bashkë në ato çaste dhe dëshirën për të qenë pjesë e saj. Vizitorët, shumica prej tyre nga Peja, njohën njerëzit në fotografi, duke i dhënë asaj kështu dimension interaktiv që unë as e kisha përllogaritur, as e kisha parashikuar. Shumicën e kohës, muri qendror përdorej si sfond, ku vizitorët pëlqenin të përfshiheshin në fotografinë e takimit për pajtim.

Autorë: Vladimir Miladinoviq
"KO200436 (23 July 1999) Vend (KV/004)", Qymyr druri në letër, 188x151cm, 2018

IMAGJINATA SI E VËRTETË

MILENA **POPOVIQ**

Është gazetare në Beograd. Ajo merret me një sërë temash shoqërore dhe fokusi i punës së saj si gazetare kryesisht është tek tema e ballafaqimit me të kaluarën. Përveç artikujve që shkruan, ajo ka qenë bashkëautore e dokumentarit "Gratë shqiptare janë motrat tona".

Procesi i ndërtimit të identitetit kombëtar në Serbi pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë ka qenë i privuar nga të gjitha faktet e pakëndëshme dhe nga çdo gjë që shoqëria, komuniteti ose individët e kishin të vështirë të pranonin. Sidoqoftë, arti ia ka marrë narrativës zyrtare hapësirën e pakëndëshme përplot ngjarje shoqërore të papërpunuara dhe traumatike nga e kaluara e afërt. Paradoksalisht, kur faktet e humbasin meritën, imagjinata që ata frymëzojnë është i vetmi mjet që ka fuqinë të arrijë tek e vërteta.

Ndërsa amnezia politike po përpiqet të shtypë zbulimin e varrezës masive në Batajnicë, ku u gjetën trupat e shqiptarëve të Kosovës të vrarë, dy autorë

nga Beogradi, Ognjen Gllavonjiq dhe Vladimir Milladinoviq, secili me ndërhyrjen e vet artistike, kanë depërtuar me sukses në botën e paprekshme të shmangies, mohimit dhe shpërfilljes.

A po ballafaqohemi me përgjegjësinë për krimet e kryera dhe si po e bëjmë këtë? Këto janë pyetjet kyçe që ngre skenaristi dhe regjisori Ognjen Gllavonjiq në filmin e tij të ri të metrazhit të gjatë "Ngarkesa". Në film, Gllavonjiqi merret me rrugëtimin e një shoferi të një kamioni-frigorifer, i cili nuk ka dijeni se po transporton nga një lokacion në tjetrin trupat e personave të vrarë dhe në të njëjtën kohë, i bën vetes pyetjen se a dëshiron të dijë se çfarë transporton. Audienca vendore ende nuk ka patur rastin ta shohë këtë film, i cili u shfaq këtë vit në Festivalin e Filmit në Kanë.

Autorë: Vladimir Miladinoviq
"ACE68570R0000253363 Fotografija tregon vendin se ku është gjetur babai i viktimës.", Qymyr druri në letër, 188x151cm, 2018

Gjatë procesit të gjatë të krijimit të këtij projekti, Gllavonjiqi bëri edhe një dokumentar me titull "Thellësia dy". E njëjta temë, perspektivë e ndryshme.

"Thellësia dy"është në të vërtetë emërtimi i koduar i operacionit sekret për transferimin e trupave të civilëve të vrarë nga Suhareka në Kosovë drejt një varreze masive në Batajnicë, Serbi.

Në film ndërthurren deklaratat e dëshmitarëve pa emër nga arkivat e gjykatave dhe fotografi të zonës ku janë kryer krimet. Aktori kryesor i filmit në të vëretë është narratori, i cili e dërgon audiencën në një hapësirë personale të imagjinatës, krijimit dhe përjetimit të vetë ngjarjes.

Ashtu si shpjegon autori, këta filma janë hapësira dhe mundësia për të ngritur zërin për personat, ngjarjet dhe vendet që ai konsideron se të lëna anash, të fshehura, në heshtje dhe të harruara. Kjo përzierje e mungesës së njohurive dhe interesit për rrethanat e ngjarjes ka ndikuar edhe tek ajo se si janë formuluar dhe bërë pyetjet e shumta, që, sikurse thotë ai, e shtynë të bëjë dy filma, në fillim filmin e me trazhit të gjatë dhe më pas, papritur, edhe dokumentarin.

Artisti i artit pamor Vladimir Milladinoviq po ashtu po përpiqet të krijojë një hapësirë për imagjinimin e së kaluarës "problematike" përmes artit të tij. Përgjatë një procesi të stërgjatë deri në dhimbje të replikimit dhe kopjimit me besnikëri të proceseve gjyqësore, dokumentave zyrtarë, provave dhe listave të sendeve të gjetura që i përdor për të identifikuar trupat nga varreza masive e Batajnicës, ai krijon vizatimet e tij. Seria e punimeve të titulluara "Tokë e shqetësuar" përbëhet nga peisazhe që artisti i ka krijuar duke interpretuar fotografi të forenzikës, ashtu si Gllavonjiqi me filmin e tij, të cilat na frymëzojnë për të qëmtuar se çfarë ka ndodhur atje në të vërtetë.

Ashtu si shpjegon Milladinoviqi, duke përkthyer materialet e arkivës në art, ai thekson rëndësinë e narrativës së shtypur apo të eliminuar nga e kaluara në procesin e rikrijimit të marrëdhënieve në të tashmen. Përveç pyetjeve për përgjegjësinë historike, artisti hulumton edhe marrëdhënien ndërmjet tekstit dhe imazhit, pra dëshmisë dhe imagjinatës. Sa mund ta dëshmojmë të kaluarën traumatike nëse nuk jemi në gjendje ta imagjinojmë? A është fotografia dëshmi e mjaftueshme që ne të besojmë?

Prandaj, Milladinoviqi përdor artin e tij pyetjen për të ngritur pyetje për dëshmitë që kemi, çfarë na thonë dhe çfarë fuqie kanë. Përmes ndërhyrjeve artistike, ai rishqyrton se çfarë mund të bëjmë tjetër si shoqëri me trashëgiminë nga lufta e kaluar.

Ndërsa historia zyrtare krijon atë që është e pranueshme, arti na ofron hapësirë alternative për të interpretuar të kalurën dhe për ta rifuqizuar të vërtetën, gjë që shoqëria e ka tradhëtuar.

Diamanti i Shkupit

Çarshia e Vjetër

VENHAR
RAMADANI

Kur nis ta njohësh Shkupin më mirë dhe dëshiron të përjetosh traditën e kryeqytetit të Maqedonisë, ndjen se në këtë qytet ka shumë ndarje. Këtë e kupton, pasi jeta në Shkup është e ndarë përgjatë vijës së etnive që jetojnë në të dy anët e Shkupit. Ana shqiptare dhe ajo maqedonase. Kjo është pamja e përgjithshme e Shkupit, edhe pse shpeshherë ky perceptim nuk përkon me realitetin.

Realiteti është i ndryshëm – ai është më i pasur dhe më i dinjitetshëm se sa duket në fillim. Gjallëria e njerëzve është më e rëndësishme se sa mënyra në të cilën është organizuar sistemi. Me një organizim më dinjitoz ndërmjet komuniteteve në të ardhmen, që edhe është qëllimi, edhe Shkupi do të ketë jetë pa ndonjë dallim dhe për të gjithë. E gjitha ajo që nevojitet për jetesën në Shkup është të marrim një shembull nga jeta në Çarshinë e Vjetër të Shkupit. Një miniaturë e bukur, e pasur dhe e përmbushur, ku të gjithë mund të veprojnë, punojnë dhe jetojnë. Shkupi ka shumë pasuri dhe Çarshia e Vjetër e Shkupit është pasuri universale që i përket të gjithëve: shqiptarëve, maqedonasve, turqve, romëve, serbëve, vllehëve, boshnjakëve dhe të tjerëve. Çarshia e Vjetër e Shkupit i takon turistëve që vijnë të shijojnë çajin dhe qebabët e shijshëm. Çarshia e Vjetër i takon besimtarëve që vizitojnë xhamitë dhe

Autore: Kristina Lozanovska

Autore: Kristina Lozanovska

kishat dhe të pasionuarve pas historisë të cilët shkojnë në Kalanë e Shkupit, që gjithashtu përfaqëson një pasuri unike, një shtojcë historike të Shkupit të lashtë.

Të gjitha këto së bashku kanë për qëllim të lidhin dy pjesët e rëndësishme të Shkupit. Të parapara të funksionojnë jo vetëm si urë lidhëse, por edhe si mjet i rëndësishëm për zhvillimin e Shkupit. Rruga e mjeshtërve (zanatlinjve) të arit, të filigranit, të kostumeve të vjetra popullore për të gjitha kulturat e pranishme në Maqedoni vetëm sa ia shtojnë bukurinë kësaj lagjeje kulturore. "Çarshia e Vjetër është Maqedonia, Maqedonia është Çarshia e Vjetër" është një thënie që përmbledh të gjithë historinë e Çarshisë së Vjetër që nga fillimi. Kur kërkon në internet diçka për Maqedoninë, rezultatet e kërkimit menjëherë të lidhin me Çarshinë e Vjetër të Shkupit. Kjo ndodh pasi turistët e kanë sugjeruar si vendin që u ka lënë përshtypje gjatë vizitës së tyre: ngrohtësia, diversiteti dhe shpirti që mund të ndjehen në çdo gur të kësaj lagjeje të veçantë. Në Trip Advisor ky vend renditet i shtati kur kërkoni për Maqedoninë. Pra, është në listën e 10 vendeve më të vizituara dhe sugjerohet nga turistët.

Çarshia e Vjetër konsiderohet si diamanti i Shkupit, për shkak të pasurisë kulturore, ekonomike dhe të atributeve shoqërore. Është diamant, pasi ngërthen në vetvete të gjithë pasurinë shoqërore dhe diversitetin etnik. Është diamant, pasi ruan brenda lidhjen ndërmjet Shkupit të Vjetër dhe Shkupit të Ri. Është diamant, pasi shumë breza kanë ushqyer familjet atje dhe bizneset kanë zhvilluar ekonominë e vendit. Rruga me kalldrëm mund të jetë ndërruar disa herë deri tani, mirëpo është vlerë kulturore e Çarshisë së Vjetër, për të treguar se e kaluara e pasur ka një energji pozitive për të ndriçuar të ardhmen. Kalldrëmet të bëjnë të besosh se je në ndonjë vend të lindjes, por kur e përjeton, Pazari i Vjetër të bind se je në perëndim dhe shpirti i zhvilluar të jep perspektivë. Rrugët me kalldrëm lidhen me Kalanë e Shkupit, me tregun që njihet si Bit Pazar, me xhamitë dhe me kishat, me sinagogat dhe muzetë, me Sahat Kullën dhe shumë struktura të tjera që janë të paharrueshme. Brenda Çarshisë së Vjetër është Skënderbeu, heroi kombëtar i shqiptarëve dhe Filipi i Dytë i Maqedonisë. Periudha të ndryshme historike dhe besime të ndryshme fetare që kurrë nuk kanë qenë shkak për konflikte etnike, fetare, kulturore apo të vendit. Që të gjithë kanë jetuar në harmoni, të sigurtë se punojnë dhe jetojnë në pasurinë më të madhe të Shkupit. Edhe pse qeveritë nuk kanë bërë shumë për Çarshinë e Vjetër deri tani, ky vend shpesh ka mbijetuar edhe pa përkrahje institucionale, por vetëm nga shpirti i atyre që e duan dhe që jetojnë nga dhe për Çarshinë e Vjetër. Para se të gjendet, diamanti mund të jetë i fshehur në dhé ose i groposur për vite të tëra. Qytetarët, afaristët, zanatlinjtë, artistët dhe të tjerët e kanë mbajtur gjallë Çarshinë e Vjetër. UNESCO e ka vendosur në listën e zonave të mbrojtura, ndërsa vetë vendi, Maqedonia, në vitin 2008 miratoi një ligj të posaçëm për Çarshinë e Vjetër. Edhe pse mbrohet me ligj, që nga ajo kohë Çarshia e Vjetër nuk ka parë ndonjë investim të madh, por as edhe ndonjë mbrojtje nga ata që e dëmtojnë në forma të ndryshme. Diamanti i Shkupit është mbrojtur nga njerëzit që e vizitojnë çdo ditë.

Diamanti i Shkupit, Çarshia e Vjetër, mbrohet nga qytetarët, pavarësisht se çfarë identiteti grupor kanë. Ajo mbrohet nga e kaluara dhe nga e ardhmja. Ajo mbrohet nga Zoti, pavarësisht besimeve fetare. Ajo mbrohet nga duart e punëtorëve që në mes të ditës pinë çaj dhe shpresojnë për ditë më të mira. Edhe pse gjendet në mes të një Shkupi modern dhe melankolik të së kaluarës, Çarshia e Vjetër mbron me fanatizëm pasurinë e saj të pashtershme. Ajo mbron kulturën, shpirtin dhe idenë që mbledh bashkë të gjithë. Të gjithë në një vend, një vend për një të ardhme të përbashkët të ndritshme. Një jetë për të gjithë në Maqedoni është shpirti i ri i Maqedonisë. Ashtu si vetë Çarshia e Vjetër që ka qëndruar që nga fillimi. U deshën më shumë se 27 vjet që dikur ta merrte shpirtin e Çarshisë së Vjetër, ta shkruante si program politik dhe të bënte pastaj përpjekje për ta vënë në zbatim. Është shumë e thjeshtë, është dashur të marrin parasysh përvojën e të gjithëve dhe të bënin një strukturë shtetërore funksionale nga miniversioni. Diamanti është gjetur. Ai ka ekzistuar. Ne nuk ishim në gjendje ta shihnim. Ne e kemi gjetur diamantin. Ka filluar të ndriçojë! Drita e diamantit na ka verbuar pasi ishim mësuar të shihnim vetëm negativen, të shihnim vetëm errësirën!

IMPRESSUM

KRYEREDAKTORE
Vanessa Robinson-Conlon

EKIPI REDAKTUES:
Sunita Dautbegoviq-Boshnjakoviq, Vjera Ruljiq, Martin Filipovski, Vjollca Islami Hajrullahu, Nehari Sharri

AUTORË:
Borka Paviqeviq, Elma Selman, Erëmirë Krasniqi, Dardan Hoti, Milena Popoviq, Milenko Bogdanoviq, Simona Atanasova, Venhar Ramadani

DIZAJNI DHE SHTYPI:
Envinion

PËRTHIMI:
LBG Communications (shqip), Bjanka Pratellesi (BKS), Martina Kimovska (maqedonisht)

KORREKTURA GJUHËSORE:
LBG Communications (shqip dhe anglisht), Zinaida Lakiq (BKS), Zhanet Ristoska (maqedonisht)

KONTAKT:
balkan.perspectives@forumzfd.de

VENDI I BOTIMIT:
Këln

dealing with the past

Për më shumë artikuj dhe informacion lidhur me tematikën e ballafaqimit me të kaluarën, vizitoni uebfaqen tonë:
www.dwp-balkan.org

Balkan.Perspectives botohet nga forumZFD.

Forumi i Shërbimit Civil Paqësor (forumZFD - Forum Ziviler Friedensdienst), është organizatë gjermane e themeluar në vitin 1996. Kjo organizatë trajnon dhe angazhon ekspertë të paqes në rajonet e konfliktit që të bashkëpunojnë me akterët vendorë për të promovuar bashkëjetesë paqësore dhe zgjidhje pa dhunë të konflikteve. Partneri strategjik për Ballkanin Perëndimor është Pax Christi në Dioqezën e Aachen.

Në Ballkanin Perëndimor, fokusi është tek projekte në fushën e ballafaqimit me të kaluarën dhe për zhvillim të dialogut në mes të grupeve kundërshtare. Këtu përfshihen projektet e ndërmjetësimit nëpër shkolla, mbështetja e shoqërisë civile ose zhvillimi i kapacitetit të medias për një qasje më konstruktive ndaj ballafaqimit me të kaluarën.

Programi financohet nga Ministria Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik e Gjermanisë (BMZ).

MOHIM I PËRGJEGJËSISË

Balkan.Perspectives është krijuar si një platformë rajonale për debate konstruktive mbi ballafaqimin me të kaluarën. Pikëpamjet e shprehura në këtë revistë janë ato të kontribuesve përkatës dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e redaktorit apo të forumZFD-së dhe partnerëve të tij. Botuesit i kanë kontrolluar me kujdes lidhjet e internetit të promovuara në këtë revistë, por ata nuk mund të mbahen përgjegjës për përmbajtjen e faqeve të jashtme të internetit. Kopjimi dhe rishpërndarja e këtij materiali, qoftë në formë të shtypur apo elektronike është i pranueshëm, por vetëm nëse teksti nuk ndryshohet dhe nëse përfshihen citimet e duhura. Për këtë nuk kërkohet pagesë.

Forumi i Shërbimit Civil Paqësor |
Forum Ziviler Friedensdienst e. V. (forumZFD)

- **Zyra në Kosovë:**
  Sejdi Kryeziu 16 - Pejton
  10000 Prishtinë
- **Zyra në Bosnje dhe Hercegovinë:**
  Rr. Branilaca Sarajeva 19 B
  71000 Sarajeva
- **Zyra në Serbi:**
  Resavska 16a
  11000 Beograd
- **Zyra në Maqedoni:**
  Rr. Naum Naumovski Borche 88a
  1000 Shkup